



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

NJOFTIM

Data
20.6.2022

Për zhvillimin e seancës publike nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Nr. Protokollit
2750

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për shqyrtimin dhe miratimin e akteve në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, vendosa të zhvilloj seancë publike:

Data e seancës 23 Qershor 2022, ora 11:30

Rendi i ditës:

1. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj z. Edison Memolla Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, z. Denis Dedej Përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zj. Ana Dhamo Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, z. Luan Shehi Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zj. Margarita Dedej Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zj. Mimoza Bidaj Drejtorit të Kopështit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”;
2. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare,” ndaj z. Fatmir Juka, Drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, z. Xhemal Bushati, kandidati për kryetar i bashkisë Shkodër dhe Partisë Demokratike, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”;
3. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Eriselda Sefa, kandidate për kryetar të Bashkisë Lushnjë, z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”;
4. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Majlinda Angoni, kandidate për kryetar të Bashkisë Shkodër, z. Haki Çako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”;

5. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Majlinda Angoni, kandidate për kryetar të Bashkisë Shkodër, Qendrës Shëndetësore “Rrethina”, Ambulanca Dobraç, zj. Edona Tafa dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”;
6. “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Emirjana Sako, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

Materialet e rendit të ditës mund t'i gjeni të publikuara në faqen e KQZ-së në internet www.kqz.gov.al, në rubrikën Njoftime.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



The image shows a circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPERISE" at the top and "KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink, which appears to be "Ilirjan Celibashi".